

## Raport Muaji Qershor 2020

### Informacion bazë

Administrimi i Fondit	<b>Shoqëria Raiffeisen Invest sh.a</b>
Monedha	<b>Euro</b>
Datë Lancimi	<b>22 Nentor 2012</b>
Vlera fillestare e kuotës	<b>100</b>
Shuma fillestare minimale	<b>250</b>
Shuma minimale pasuese	<b>50</b>
Komision në hyrje	<b>0.00%</b>
Komision në dalje	<b>0.00%</b>
Komision Administrimi në vit	<b>1.50%</b>
Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta	<b>Referojuni informacionit ne deget e RBAL</b>

### Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të mund t'i sigurojë investitorit një kthim nga investimi në perputhje me një menaxhim të kujdesshëm të portofolit duke ruajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetit të nevojshëm.


Nje pjese e rendesishme e asetete te fondit mund te investohen ne bono dhe obligacione thesari te Qeverise se Republikes se Shqiperise, te emetuara ne monedhen euro. Megjithate, frekuenca e emetimeve ne euro nga Qeveria e Republikes se Shqiperise do te percaktoje shkallen ne te cilen Fondi do te investoje ne keto lloj instrumentash.

Fondi eshte i pershtatshem per individe dhe subjekte juridike te cilet mendojne se objektivi i investimit i Fondit perputhet me kerkesat dhe pritshmerite e tyre.

### Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët  
Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë  
Përfitimet tipike më të larta



Fondi Raiffeisen Invest Euro është në kategorinë e tretë të Profilit të Rrezikut dhe Përfitimit

Duke marrë parasysh luhatshmerine e lartë të fondit gjatë tremujorit të fundit (periudha Mars - Qershor 2020), e shkaktuar nga situata pandemike globale, fondi Raiffeisen Invest Euro zhvendoset nga kategoria e dytë në kategorie e trete te profilit të rrezikut dhe perfitueshmerise.

Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmerisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik. Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmerinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

## Të dhëna për Fondin në 30 Qershor 2020


Vlero Neto e Aseteve	72,495,852.64
Numri I Investitoreve	3,028
Cmimi I Kuotes	113.4875
<b>*Kthimi Vjetor nga Investimi (30.06.2019-30.06.2020)</b>	<b>-4.38%</b>

\*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

## Struktura e Portofolit të investimeve më 30 Qershor 2020

Portofoli i fondit Euro është ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga balancimi i kategorive të ndryshme të investimeve në bono dhe obligacioneve qeveritare dhe të korporatave. Kjo bëhet me qëllim për të diversifikuar portofolin dhe ulur rrezikun që vjen nga ekspozimi i gjere ndaj pak instrumenteve.


Përqindja e alokimit të asetëve bëhet në përputhje me politikën e investimit dhe kritereve të specifikuar në prospektin e fondit. Shpërndarja e asetëve mund të jetë jashtë objektivit të përcaktuar për shkak të ndryshimeve të kushteve të tregut. Asetet e Fondit janë të investuara në instrumente financiare që i përkasin emetuesve që performojnë në industri të ndryshme të ekonomisë duke bërë të mundur rritjen e diversifikimit të portofolit.



Obligacionet të quajtura “dytësore” (ose me termin financiar subordinated) janë përafërsisht 6.28% e portofolit, në fund të Qershorit. Duke iu referuar strukturës së portofolit të investimeve të fondit më 30 Qershor 2020, përqindja e asetëve të fondit e investuar në Obligacione Shtetërore qëndron në 50.2% të asetëve, dhe 38.22% e tyre i përkasin obligacioneve të Qeverisë Shqiptare, të tregtuar në tregje nderkombetare. Fondi mund të balancojë ekspozimin ndaj instrumenteve të ndryshme në varësi të kushteve të tregut për të arritur objektivat e tij afatgjatë.

Asetet e fondit të investuara në obligacione të korporatave me vlerësime të larte janë rritur në 24.76% të asetëve dhe investimet në Fondet e Investimeve janë 21% e totalit të aktiveve. Keto fonde investimi gjithashtu kanë në fokus investime në tregun e obligacioneve. Likuiditeti i mbajtur në cash dhe depozita është zvogeluar në 4% e totalit të asetëve të fondit.

Vlera neto e asetëve të fondit është rritur në nivelin 72.5 milion EUR në fund të Qershorit.



## Zhvillimet dhe informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare gjate muajit Qershor

**Gjatë muajit Qershor**, ecuria e tregjeve financiare është përmirësuar sepse tregjet e kapitalit janë mbështetur pozitivisht nga lehtësimi global i masave kufizuese, nga indikacionet për një pakete të madhe fiskale të vendeve të Bashkimit Europian dhe të ndikuar nga zgjerimi i programit të Bankes Qendrore Europiane (BQE) për blerjen e obligacioneve.

Si rezultat, primet e rrezikut në tregjet europiane të kreditit kanë vazhduar të bien dhe rimëkëmbja e tregut të obligacioneve të korporatave dhe tregut të aksioneve ka vijuar përgjatë gjithë muajit. Rritja e vlerës së programit të emergjencës pandemike prej 600 miliardë eurosh nga Banka Qendrore Europiane dhe njoftimi i Bankes qendrore të SHBA-se (FED) për blerje direkte të obligacioneve të korporatave ishin nxitës të rëndësishëm.

**Banka Qendrore Europiane** ka vendosur të rrisë programin e emergjencës pandemike në një total prej 1.35 miliardë eurosh duke e zgjatur procesin e blerjeve të paktën deri në Qershor 2021. Normat e interesit do të qëndrojnë në nivelin aktual ose në një nivel më të ulët derisa inflacioni të lëvizë në mënyrë të qëndrueshme drejt objektivit të synuar. Sipas Bankës Qendrore Europiane, pritshmerite për rritjen reale të ekonomisë dhe normën e inflacionit janë ulur për vitet e ardhshme, ndërsa sipas parashikimeve të **Rezerves Federale** (FED), tani banka qendrore amerikane nuk e sheh rritjen e 1-re të normës së interesit përpara fundit të vitit 2022.

Nga ana tjetër, numri i personave të infektuar me Covid-19 është rritur globalisht gjatë muajit qershor. Sezoni i raportimit të rezultateve të kompanive do të fillojë në muajin Korrik dhe të ardhurat / fitimet e korporatave priten të bien. Rezultatet e kompanive për tremujorin e dytë do të jenë një vlerësim i dëmimit që pandemia ka shkaktuar në ekonominë reale.

Më 09 qershor, **Qeveria Shqiptare** arriti me sukses të emetojë Eurobondin e ri 7 vjeçar në tregjet ndërkombëtare për shumën prej 650 milion euro, me një normë kupon prej 3.50% dhe yield 3.625%.

Interesimi i investitorëve ishte shumë i lartë, duke arritur në rreth 3.2 miliardë euro pjesëmarrje dhe ishte shumë i larmishëm në shpërndarjen e tij gjeografike. Shqipëria vlerësohet me notën B + nga agjensia e vlerësimit Standard & Poor dhe B1 nga Moody's.

## Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri në 30 Qershor 2020


Gjatë muajit Qershor, portofoli i investimeve ka performuar shumë mirë dhe ka postuar fitime. Vlera e kuotes së fondit Euro është rritur me 0.61% në krahasim me muajin e kaluar.

**Kthimi vjetor neto është -4.38% në 30 Qershor 2020.** Çmimi i kuotës është rritur me 1.68% me baze vjetore që nga lancimi në vitin 2012.

Më 30 Qershor 2020, kthimi neto është -0.5% (bazë vjetore) për investitorët të cilët janë 3 vjet në fond dhe 1.01% (bazë vjetore) për investitorët që janë 5 vjet në fond.

Fokusi i investimeve është në obligacionet e korporatave me vlerësime të larta të kreditit, të cilat mbështeten nga programi i blerjeve të Bankave Qendrore. Gjatë muajit Qershor Fondi Euro arriti të investojë në Eurobondin e ri 7 vjecar të emetuar nga Qeveria Shqiptare.

Asetet e Fondit Raiffeisen Invest euro janë të investuara në obligacione të denominuar në euro, të tregtuara në tregjet ndërkombëtare dhe për pasojë ato ndikohen nga zhvillimet e ekonomisë botërore. Ecuria e mirë e tregut të obligacioneve gjatë muajit Qershor ka ndikuar pozitivisht në investimet e fondit Euro.



Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon në varesi të kushteve të tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatsëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Lulahshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve të investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investitorët e fondit Raiffeisen Invest Euro dhe të gjithë fondeve të administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen të kenë një horizont sa më të gjatë investimi për të përfituar një kthim optimal nga investimi dhe në këtë mënyrë në periudhë afatmesme apo afatgjatë të kenë mundësi të rikuperojnë edhe efektet negative të krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen që të ruajnë investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qëndrimit në fond të nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga pandemia globale, sepse në këtë mënyrë nuk do të rrezikojnë të dalin nga fondi në momentin e gabuar për investimin e tyre.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analizë të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit.

Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sh.a., në web site [www.raiffeisen-invest.al](http://www.raiffeisen-invest.al) ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.